



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Kom.Dh.Shk.II.nr.1158/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Fitorja” SH.P.K., me seli në adresën rr.“ E Reçakut” në Ferizaj, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit K.A. avokat në Ferizaj, kundër debitorit Ministra e Mbrojtjes, me adresë Kazerma “Adem Jashari” në Prishtinë, për shkak të borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e autorizuarit të kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KPPP.nr.1194/2022 të datës 26.06.2023, me datë 12.03.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e autorizuarit të kreditorit “Fitorja” SH.P.K., me seli në adresën rr.“ E Reçakut” në Ferizaj, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KPPP.nr.1194/2022 i datës 26.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1194/2022 të datës 26.06.2023, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Ministra e Mbrojtjes me seli në Prishtinë, ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.315/21 të datës 08.10.2021 të lejuar nga përmbaruesi privat Mubarak S. Shumolli, me seli në Ferizaj, dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa të aprovohet si e bazuar, ashtu që aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit

nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa e autorizuarit të kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Fitorja” SH.P.K., me seli në adresën rr.“ E Reçakut” në Ferizaj, me datë 08.10.2021 ka paraqitur propozim për përmbartim, kundër debitorit Ministra e Mbrojtjes, me adresë Kazerma “Adem Jashari” në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr. 0002-105/19 të dt: 15.05.2019, faturës nr. 0002-78/20 të dt: 06.05.2020, faturës nr. 0002-79/20 të dt: 07.05.2020, faturës nr. 0002-81/20 të dt: 08.05.2020, faturës nr. 0002-84/20 të dt: 21.05.2020, faturës nr. 0002-165/20 të dt: 13.10.2020, faturës nr. 0002-167/20 të dt: 20.10.2020 dhe faturës nr. 0002-203/20 të dt: 29.12.2020, në shumë e përgjithshme prej 510.00 Euro.

Përmbartuesi privat Mubarak S. Shumolli, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin P.nr.315/2021 të datës 08.10.2021, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – faturës nr. 0002-105/19 të dt: 15.05.2019, faturës nr. 0002-78/20 të dt: 06.05.2020, faturës nr. 0002-79/20 të dt: 07.05.2020, faturës nr. 0002-81/20 të dt: 08.05.2020, faturës nr. 0002-84/20 të dt: 21.05.2020, faturës nr. 0002-165/20 të dt: 13.10.2020, faturës nr. 0002-167/20 të dt: 20.10.2020 dhe faturës nr. 0002-203/20 të dt: 29.12.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që të paguaj në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturave në shumë prej 510.00 euro. Kundër këtij urdhri debitorit ka paraqitur prapësim me datë 28.10.2021, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin, me arsyetimin se faturat e bashkangjitura si objekt përmbartimi nuk janë të nënshkruara dhe të vulosura nga personat kompetent, çdo kompani që kryen shërbime me kontrollim teknik të automjeteve të FSK-së është i obliguar që faturat si sjellë në G4 –Ship dhe pasi ajo të vuloset i njëjti duhet të nënshkruaj në librat e pranimit dorëzimit të faturat, faturat e bashkangjitura propozimit për përmbartim nuk janë të pranuar nga ndonjë pjesëtarë i FSK-së, sepse ata do e shkruanin gradën emrin dhe mbiemrin para nënshkrimit. Prandaj procedimi i faturave duhet të bëhet në mënyrë të rregullt dhe të pranohet vërtetohen nënshkruhen nga zyrtari kompetent në Ministrinë e Mbrojtjes, që fatura të procedohet në mënyrë të rregullt për pagës, pos tjerash ka theksuar se faturat objekt përmbartimi nuk i plotësojnë kushtin sipas nenit 21 të LPP-së, andaj ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri i përmbartuesit privat. Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditorit me datë 09.11.2021, duke theksuar se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe rrjedhimisht në kundërshtim të plotë me nenin 69 dhe 71 të LPP-së, nuk i ka bashkangjitur as një provë të vetme prapësimit me të cilat do të vërtetonte pretendimet e paraqitura, andaj ka propozuar që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbartimor.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.1194/2022 të datës 26.06.2023, me të cilin ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit Ministra e Mbrojtjes me seli në Prishtinë, ka anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.315/21 të datës 08.10.2021 të lejuar nga përmbartuesi privat Mubarak S.

Shumolli, me seli në Ferizaj, dhe ka përfunduar në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata ka theksuar se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është mbështetur propozimi për përmbarim janë bashkangjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk janë deponuar origjinali apo kopja të vërtetuar tek organi kompetent, e rrjedhimisht propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me neni 37 të LPP-së.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar po ashtu se, aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 lidhur me nenin 208 të LPK-së.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se, në bazë të nenit 21 dhe 29 të LPP-së, organi përmbarues e cakton përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues dhe dokumentit të besueshëm. Ndërsa me dispozitën e nenit 37 të LPP-së përcaktohet se: *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*, ndërsa me dispozitën e nenit 40 të LPP-së, përcaktohet se: *“ Propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë kërkesën përmbarimore nga paragrafi 1, të nenit 38 të LPP-së, ku parashihet se: “Propozimi për përmbarim duhet të përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi...”*. Në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm për faktin se dokumenti i besueshëm – faturat, në bazë të cilave është lejuar përmbarimi nuk i përmbajnë të gjitha elementet e dokumentit të besueshëm, ngase të njëjtat nuk janë origjinale apo kopje të vërtetuara, por janë vetëm kopje të pa vërtetuara nga ana e kreditorit dhe në të njëjtën kohë janë të pa përmbarueshme.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë vlerëson se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me atë se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për faktin se sipas vlerësimit të gjykatës ankimore në rastin konkret, përmbarimi është lejuar në bazë të faturave të cilat nuk janë origjinale apo kopje të vërtetuara dhe rrjedhimisht i bie që është në kundërshtim të plotë me dispozitat e lart cekura, andaj edhe në këtë drejtim rezultojnë si të pathemelta pretendimet ankimore të kreditorit, të cilat kjo gjykatë i refuzoi si të pathemelta, ndërsa aktvendimin e ankimuar vendosi ta vërtetojë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika (b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e shkallës së dytë

Kom.Dh.Shk.II.nr.1158/2023 me datë 13.02.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova